



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 3124, prot

Datë 03/10/2025

P/VENDIM

Nr. 32, datë 03/10/2025

PËR
NJË SHITESË NË V.K.B. NR. 64, DATË 23/12/2024,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2025”.

Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni “18”, neni “34”, neni “40”, neni “41”, neni “54” germa “Dh”, neni “55” pika 3, neni “64” germa C, Ligjit 68/2017 datë 27/04/2017. “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni “4”, neni “5” germat “a & ç”, neni “6” germa “d”, neni “7” pika “1”, neni “21” pika “3”, neni “23”, neni “33”, neni “39”, neni “40”, neni “41”, Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për Manaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Ligjit 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Ligjit 10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit Vjetor nr. 3, datë 28/02/2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, Udhëzimit nr. 23, datë 30/07/2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetorë afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 9, datë 20/03/2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, si dhe Akt-Marrveshjes ndërmjet Bashkisë Fushë Arrëz dhe Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 3021, datë 29/09/2025, Për “Bashkëpunim ndërvendor në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike për kryerjen e investimit me objekt, Rikonstruksion i rrugës Lagje e re Qytet Fushë Arrëz, Bashkia Fushë Arrëz”, pas diskutimit nga Këshilltarët

VENDOSI:

1. Të rrisë limitin e të ardhruave në vlerën 14 895 000 lekë.
2. Kjo vlerë do të përdoret për investimin në objektin, Rikonstruksion i rrugës Lagje e re Qytet Fushë Arrëz, Bashkia Fushë Arrëz, i cili sistemohen në Grup, Titull, Kapitull, Artikull sipas tabelës së mëposhtme:

lekë

Gr.	Tit.	Kap.	Viti	Artikull					Shuma
				600	601	602	230	231	
00	06260	05	2025					14 895 000	14 895 000
Totali								14 895 000	14 895 000

3.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e zhvillimit ekonomik, Financës, Buxhetit dhe Tatim taksave, Inspektori për informimin publik në Bashkinë Fushë-Arrëz, si dhe Dega e Thesarit Pukë.

DREJTORI I FINANCËS

Dritan LIKA



KRYETARI

Hil CURRI

JURISTI

Redona HASANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 3124/1, Prot.

Fushë-Arrëz, me 3.10.2025

RELACION

Lënda: Për rritjen e limit të të ardhurave për investime.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Fushë – Arrëz

Bashkia Fushë Arrëz ka përfituar nga Këshilli i Qarkut Shkodër një investim në objektin, Rikonstrukcion i rrugës Lagje e re Qytet Fushë Arrëz, Bashkia Fushë Arrëz me vlerë 14 895 000 lekë. Ky investim ka dy vite që nuk është realizur nga ky institucion për arsye të ndryshme, duke krijuar mjaft problematika në këtë segment rrugorë për këtë pjesë të rëndësishme të Qytetit. Me VKQ nr. 20, datë 24.09.2025 Këshilli i Qarkut Shkodër këtë fond ja ka transferuar Bashkisë Fushë Arrëz në mënyrë që procedura dhe realizmi i këtij Investimi të kryhet nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz.

Bashkia Fushë Arrëz ka nënshkruar Akt Marrveshjen nr. 3021, prot, datë 29.9.2025 me Këshillin e Qarkut, në të cilën janë të parashikuara të gjitha modalitetet për përdorimin e këtij fondi, ku vlen të theksohet fakti se nenin 4, pika 2 të saj , citohet se fondi do të përdoret vetëm për këtë objekt investimi.

Të gjendur përballë kësaj situate e shohim emergjente ndryshimin e buxhetit për këtë vlerë duke qënë se afatet kohore për këto ndryshime janë në limitet e fundit.

Bashkia do të bëjë cdo përpjekje që të arrije të kryje procedurat ligjore për prokurimin dhe realizmin e këtij investimi.

Bashkëlidhur këtij relacioni do të gjeni dhe Projekt Vendimin perkatës.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin.

PËRGJEGJËSI I FINANCËS

Dritan LIKA

JURISTI

Redona HASANI

KRYETARI

Hil CURRI

